1. **Predstavnici Srba sa Kosova treba da formulišu listu prioriteta za dijalog.** Srbi na Kosovu treba da formulišu listu prioriteta i da insistiraju da ti prioriteti budu uključeni u dnevni red dijaloga. Iako će se dijalog neminovno usmeriti i na interesu Srba na Kosovu, druga pitanja, koja Beograd i Priština smatraju više važnim, bi mogla da zasene interesu Srba na Kosovu. Kvalitet

životnog standarda (rad struje i telefona, bezbednost, zapošljavanje, itd.) treba da ima prednost nad većim i apstraktnim interesima Beograda i Prištine. Lideri srpske zajednice treba da učestvuju u onim diskusijama dijaloga koji se odnose na pitanja kulturnog nasleđa, putnih isprava, registarskih tablica, nestalih lica, transporta, saradnje policije, sudstva, trgovine i telekomunikacija.

2. **Srbi sa Kosova treba da pripreme zajedničku platformu za dijalog.** Srbi sa Kosova očekuju da će biti uključeni u radne grupe i Beograda i Prištine. Od članova srpskih parlamentarnih stranaka na Kosovu se očekuje da će biti uključeni u prištinski tim, dok se od članova stranaka na Kosovu čije je sedište u Beogradu očekuje da će biti uključeni u beogradski tim. Članovi oba tima treba da insistiraju na pitanjima koja prvenstveno utiču na srpsku zajednicu.
3. **Beograd treba da odredi realne ciljeve dijaloga.** Beograd treba da bude realan u artikulaciji svojih ciljeva tokom dijaloga sa Prištinom i da izbegne ponavljanje grešaka iz bivših pregovora. Partnerstvo sa međunarodnom zajednicom, što olakšava dijalog, je od presudne važnosti za Beograd.

## EKONOMSKE MOGUĆNOSTI

Ekonomска održivost srpske zajednice na Kosovu treba da se posmatra u okviru šireg konteksta Kosova, jer će u suprotnom analize biti pogrešne. Kosovska ekonomija se temelji na neodrživim izvorima, kao što su državna potrošnja, doznake i međunarodna pomoć. I Albanci i Srbi se dosta oslanjaju na pomoć sa strane, bilo da se radi o doznakama albanske dijaspore ili socijalnim davanjima srpske Vlade. Međutim i ovakvi izvori pomoći su slabi, jer suočeni su teškim budžetskim deficitima vlade i Beograda i Prištine smanjuju potrošnju, Beograd umanjuje socijalna davanja, a međunarodna finansijska pomoć je u opadanju.

Kosovski BND je oko 4 milijarde evra<sup>4</sup>, sa približno 2000 evra po stanovniku što je niska cifra čak i za standarde balkanskih zemalja. Bosna i Hercegovina ima BND od približno 5000 evra po stanovniku, Albanija - 6000, Makedonija - 7000, a Srbija - 8000. Kosovski trgovinski deficit je oko 80%. Njegova izvozna vrednost u 2010. je bila oko 320 miliona evra, dok je uvoz iznosio 2,3 milijarde evra. Stopa nezaposlenosti je 45%, a stopa stanovništva koji živi u siromaštvu je 34%. U tom kontekstu, teško je kreirati ekonomske mogućnosti za bilo koju zajednicu na Kosovu. Međutim, srpska zajednica je ona koja je najmanje ekonomski aktivna.

4 The CIA World Factbook 2010.

## Preporuke

1. **Srpska zajednica treba da iskoristi svoj ekonomski potencijal.** Napori da se aktivira potencijal srpske zajednice treba da se usmere na neiskorišćene ljudske resurse i prevenciju „odliva mozgova“. Suočeni sa nezaposlenošću, mnogi mladi Srbi se sele u Srbiju u potrazi za poslom. Ukoliko se ovakav trend ne izmeni, on bi mogao da izazove ozbiljne posledice za srpsku zajednicu.
2. **Beograd treba da Srbima na Kosovu obezbedi subvencije i kredite niskih kamatnih stopa.** Vlada Srbije treba da usmeri deo svog budžeta namenjenog Srbima na Kosovu na davanje kredita niskih kamatnih stopa za mala i srednja preduzeća i za profitna ulaganja Srba. Takođe bi trebale da se dodeljuju subvencije za lokalne poljoprivrednike, jer bi to osnažilo ekonomsku bazu Srba i smanjilo njihovu zavisnost od socijalnih davanja.
3. **Beograd treba da nastavi sa socijalnim davanjima za Srbe na Kosovu.** Sve dok ekomska proizvodnja ne bude uspostavljena, socijalna davanja srpske Vlade treba da se nastave, jer su ona najbitnija za njihov opstanak. U isto vreme, Srbi u saradnji sa srpskom Vladom i kosovskim institucijama treba da podrže inicijative koje promovišu ekonomsku aktivnost.
4. **Srbi sa Kosova treba da iskoriste sistem kvota.** Srbi na Kosovu treba da iskoriste sistem kvota za zapošljavanje u javnoj administraciji, uključujući policiju, sudstvo, itd. S obzirom da je privatni sektor jako slab i da će, kratkoročno gledano, tako i ostati, zapošljavanje u javnim institucijama i kompanijama jedini način da se smanji nezaposlenost.

# **AKOMODIMI I SERBËVE NË KOSOVË**

## **Rekomandime Politike**

### **HYRJE**

Në Kosovë është duke u krijuar një system i ri politik dhe ekonomik. Niveli i angazhimit të komunitetit serb në proceset të cilat definojnë këtë sistem do të përcaktojë ndikimin dhe fuqinë e tij në shoqërinë e Kosovës. Komuniteti serb duhet të luaj rol më të madh në bërjen e politikave që ndikojnë në ardhmërinë e tij e që bëhen nga Beograd, Prishtina dhe komuniteti ndërkombëtar. Në këtë fryshtë, Këshilli për Qeverisje Përfshirëse (CIG), një organizatë joqeveritare ndërkombëtare që promovon qeverisje përfshirëse dhe të përgjegjshme, ka implementuar një iniciativë politike njëvjecare, duke zhvilluar një numër rekomandimesh me qëllim të konsolidimit të fuqisë politike të komunitetit serb.

Kjo iniciativë është financuar nga Departamenti Federal i Punëve të Jashtme të Zvicrës dhe është implementuar në bashkëpunim me të njëjtin.

Programi ka përfshirë një sërë diskutimesh me udhëheqës politik të serbëve të Kosovës, zyrtarë nga qeveria e Serbisë përgjegjës për politikat rreth Kosovës, përfaqësues serbë të shoqërisë civile, dhe kosultime individuale me zyrtarë të qeverisë së Kosovës dhe përfaqësues ndërkombëtarë. Në program janë përfshirë edhe zyrtarë komunal dhe udhëheqës lokal të partive politike. CIG ka informuar rregullisht zyrtarët në Beograd, Prishtinë dhe përfaqësuesit ndërkombëtarë rreth rezultateve të dala nga diskutimet.

Qëllimi i iniciativës ka qenë kontribuimi në konsolidimin politik të komunitetit serb dhe në përfshirjen e tij më të madhe në procesin e politikës. Pjesëmarrësit kanë prodhuar një numër rekomandimesh politike për veprim nga serbët e Kosovës, Beogradit, Prishtinës, dhe përfaqësuesit ndërkombëtarë. Rekomandimet adresojnë gjashtë fusha të rëndësishme: koordinimin e partive politike, konsolidimin institucional, pjesëmarrjen politike, politikën e Beogradit ndaj Kosovës, dialogun Beograd-Prishtinë dhe rolin e serbëve të Kosovës në të, dhe mundësitetin ekonomik.

Rekomandimet promovojnë debatin politik dhe të menduarit pragmatik dhe ndihmojnë përpjekjet lokale e ndërkombëtare për akomodimin e komunitetit serb. Në mënyrë të vecantë, këto rekomandime do të kontribuojnë në transformimin e debatit politik rreth serbëve në Kosovë nga rrafshi politik në një rrafsh më fokus në nevoja dhe mundësi, në promovimin e harmonizimit të politikave dhe bashkëpunimit mes partive serbe në Kosovë dhe mes serbëve në Kosovë dhe Beogradit, dhe do të ndihmojnë udhëheqësit politik serbë në Kosovë në artikulimin dhe përkthimin e kërkesave të komunitetit të tyre në politika publike. Këto rekomandime gjithashu do të ndihmojnë në fuqizimin e rolit të serbëve në Kosovë në dialogun mes Beogradit dhe Prishtinës.

Rekomandimet janë të bazuara në marrëveshje të gjërë të pjesëmarrësve, por jo në konsensus. Pjesëmarrësit kanë marrë pjesë në iniciativë në cilësi personale dhe pozicionet e tyre nuk reflektojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e institucioneve të cilat i përfaqësojnë. Rekomandimet do t'u shpërndahen të gjitha palëve lokale dhe përfaqësuesve ndërkombëtarë përgjegjës për bërjen e politikave lidhur me komunitetin serb.

Drejtori i programeve i CIG ka përgatitur këtë raport dhe CIG është përgjegjëse për përbajtjen e tij. Mirëpo, rapporti nuk përfaqëson apo reflekton domosdoshmërisht pikëpamjet e CIG.

## KOORDINIMI I PARTIVE POLITIKE

Komuniteti serb në Kosovë përfaqësohet nga degë të partive politike serbe me seli në Beograd dhe nga partitë politike serbe me seli në Kosovë. Të parat fuqishëm kundërshtojnë pjesëmarrjen e serbëve në institucionet e Kosovës, kurse të dytë mbështesin pjesëmarrjen. Partitë serbe me seli në Kosovë nuk njihen nga Beogradhi dhe nga një pjesë e popullatës serbe në Kosovë, duke ua bërë të vështirë që të thirren në legitimitet të gjërë dhe të veprojnë në hapësira ku partitë me seli në Beograd kanë monopol politik—në komunat me shumicë serbe në veri. Marrëdhëniet mes këtyre dy grupeve të partive politike dhe institucioneve të ndara që ato i menaxhojnë—institutionet serbe dhe institutionet e Kosovës—janë të tensionuara. Dallime të theksuara politike e ideologjike ekzistojnë edhe mes dhe brenda partive me seli në Beograd dhe atyre me seli në Kosovë, duke kontribuar në fragmentimin e spektrit politik të komunitetit serb.

Zyrtarë partiake dhe anëtarë të parlamentit lëvizin nga një parti në tjetrën, parti të reja vazhdojnë të themelohen, të vjetrat ndahan në dysh apo zhduken, dhe partitë vazhdojnë të identifikohen më tepër me udhëheqësit e tyre sesa me programet politike. Megjithatë, partitë politike serbe nuk dallojnë shumë nga partitë e komuniteteve tjera në Kosovë. Edhe ato vazhdojnë të ndahan e të rigrupohen. Arrijqtë e vjetër bashkohen dhe formojnë koalacione qeveritare, ndërsa ish aleatët arrijqësohen. Besohet se këto ndarje janë të bazuara më tepër në përfitime personale e partizane sesa në dallime ideologjike e politike.

Por politika e partive serbe nuk ka të bëjë vetëm me pushtetin, por edhe me zgjedhje politike: t'i bashkohen institucioneve të Kosovës apo t'i bojkotojnë ato dhe t'i forcojnë institucionet e Serbisë në Kosovë—të njohura edhe si institucionë paralele. Disa parti serbe morrën pjesë në zgjedhjet lokale e parlamentare të Kosovës dhe iu bashkuan institucioneve të Kosovës. Të tjerat udhëheqin një sistem të ndarë politik dhe të shërbimeve, duke ofruar edukim, kujdes shëndetësor dhe dhënie të dokumenteve. Koordinimi ndërpartiak është thelbësor në formulimin e politikave konsensuale përmirësimin e interesave të komunitetit serb.

## Rekomandime

- Partitë politike serbe në Kosovë duhet të harmonizojnë politikat e tyre.** Partitë serbe duhet të harmonizojnë—jo domosdoshmërisht t'i homogenizojnë—politikat e tyre dhe të veprojnë si një aleancë fleksibile politike. Agjendat dhe objektivat e tyre kundërshtuese po kontribuojnë në ndasitë brenda komunitetit serb. Harmonizimi i politikave do të promovojë kohezionin politik dhe shoqërор dhe forcojë fuqinë negocuese të komunitetit serb në politikën e Kosovës. Poashtu duhet të krijohen kushtet që të gjitha partitë të veprojnë të papenguara në gjithë territorin e Kosovës (p.sh. Partia e Pavarur Liberale apo Lista e Bashkuar Serbe të veprojnë lirshëm në veri).
- Serbët në Kosovë duhet të themelojnë një forum për diskutim të politikave.** Forumi duhet të përfshijë zyrtarë partiak serb, përfaqesues të shoqërisë civile, dhe anëtarë të institucioneve arsimore dhe të shërbjej si mjet për harmonizimin dhe koordinimin e politikave partiake rrëth cështjeve kyse. Me tu formuar, forumi duhet të bashkëpunoj me institucionet relevante lokale dhe ndërkombëtare, me institucionet akademike dhe me organizata të shoqërisë civile me qëllim të zhvillimit të përgjithshëm politik të komunitetit serb.
- Serbët në Kosovë duhet të angazhohen edhe në cështje joetnike.** Partitë serbe duhet të angazhohen edhe në cështje joetnike—privatizimi, buxheti i Kosovës, reforma kushtetuese dhe ligji zgjedhor—të cilat kanë pasoja për të gjithë banorët e Kosovës. Interesat e komunitetit serb dhe komuniteteve tjera janë të pajtueshme në shumë nga këto cështje.

## KONSOLIDIMI INSTITUCIONAL

Komuniteti serb është i fragmentuar jo vetëm nga një numër i madh i partive politike por edhe nga dy grupe të institucioneve lokale me objektiva të kundërtë: institucionet e Serbisë dhe institucionet e Kosovës. Institucionet e Serbisë janë të mbështetura nga Beograd kurse ato të Kosovës nga Prishtina dhe nga një pjesë e madhe e komunitetit ndërkombëtar. Institucionet e Serbisë përfshijnë institucionet politike dhe të shërbimeve: të parat kanë rezultuar nga zgjedhjet lokale serbe të vitit 2008, të parat zgjedhje lokale të Serbisë të mbajtura në Kosovë qysh nga konflikti i vitit 1999, ndërsa të dytë ekzistojnë që nga viti 1999.

Institucionet politike të Serbisë në veriun e kontrolluar nga serbët veprojnë të papenguara dhe faktikisht janë të vetmet institucionet, mirëpo veprimet e këtyre institucioneve në pjesën tjetër të Kosovës janë të kufizuara. Për dallim prej institucioneve politike, institucionet e shërbimeve të Serbisë veprojnë efektivisht si në veri ashtu edhe në jug dhe duket se nuk paraqesin ndonjë kërcënimë ndaj institucioneve të Kosovës.

Gjendja në terren sugjeron se ky paralelizëm politik institucional dëmon interesat e serbëve në Kosovë, por aktorët e përfshirë në këtë proces ngurrojnë të konsiderojnë një zgjidhje potenciale. Ekzistimi i dy palë institucioneve lokale, të Serbisë dhe të Kosovës, po bëhet problematik sidomos në komunat me shumicë serbe në jug. Serbët në Kosovë duhet të fillojnë të kërkojnë rrugë për tu bashkuar rreth një grupi të institucioneve.

## Rekomandime

- 1. Serbët në Kosovë dhe qeveria në Beograd duhet ta zgjidhin cështjen e paralelizmit institucional në komunat me shumicë serbe në Kosovë.** Pjesëmarrësit kanë pasur pikëpamje të kundërtë rreth cështjes se institucioneve paralele dhe mbajtjes së zgjedhjeve të ardhshme të Serbisë në Kosovë. Disa sugjeron se institucionet politike të Serbisë në jug duhet që gradualisht të shuhën dhe se Beogradit nuk duhet të organizojë zgjedhje tjera lokale në Kosovë. Tjerët kundërshtuan fuqishëm këto propozime, duke sugjruar te kundërtën. Megjithatë, pjesëmarrësit u pajtuan se duhet kërkuar rrugë për shuarjen graduale të institucioneve politike të Serbisë në jug por pa i dëmtuar interesat e serbëve të Kosovës, ndërsa institucionet e shërbimeve të Serbisë—edukimi, shëndetësia—duhet të operojnë derisa të arrihet një zgjidhje mes Beogradit dhe Prishtinës. Ata poashtu sugjeron që të bëhet një shqyrtim i jopolitizuar i përfitimit dhe kostos së integrimit në sistemin e shërbimeve të Kosovës. Pjesëmarrësit poashtu rekomanduan që Beogradit duhet të analizojë përfitimin dhe koston e mbajtjes së një palë zgjedhjeve tjera lokale në Kosovë para se ta marr një vendim në vitin 2012. Poashtu ka pasur pajtim të përgjithshëm mes pjesëmarrësve se institucionet politike dhe të shërbimeve të Serbisë në veri duhet të funksionojnë derisa të arrihet një marrëveshje e përgjithshme mes Beogradit e Prishtinës.
- 2. Beogradit dhe institucionet lokale në komunat me shumicë serbe në Kosovë duhet të vendosin bashkëpunim.** Beogradit duhet të komunikoj dhe bashkëpunoj me autoritetet komunale të komunave me shumicë serbe në Kosovë—Gracanicë, Shterpce, Partesh, Ranillug dhe Kllokot—nën strategjinë e “bashkëpunit pa njohje”. Tani që Beogradit ka filluar komunikimin direkt me autoritetet e Kosovës, injorimi i autoritetetëve lokale serbe është joefikas. Ky bashkëpuni mund të filloj duke bashkëfinancuar projekte infrastrukturore në komunat e përmendura më lart. Një bashkëpuni i tillë do të përmirësojë marrëdhëniet brenda komunitetit serb si dhe infrastrukturën e këtyre komunave.
- 3. Politikanët serbë në Kosovë duhet të bëhen më përgjegjës ndaj nevojave të votuesve të tyre dhe të zhvillojnë institucionë illogaridhënëse dhe të pakorruptuara.** Perceptimi i serbëve të Kosovës është se dhjetë ulëset e rezervuara dhe dy ministritë e garantuara në parlamentin dhe qeverinë e

Kosovës shpesh kanë ofruar mundësi për individë sesa një zë për serbët. Rrjedhimisht, përfaqësuesit politik të serbëve duhet të bëjnë politikë të përgjegjishme dhe të vendosin interesat e komunitetit të tyre mbi interesat politike, duke ngritur kështu besimin e votuesve në përfaqësuesit e tyre politik dhe në institucionet demokratike. Megjithatë, duhet theksuar se edhe komunitetet tjera të Kosovës kanë perceptime të njejtë për përfaqësuesit e tyre politik.

## PJESËMARRJA POLITIKE

Komuniteti serb në Kosovë heziton të marrë pjesë plotësisht në institucionet e Kosovës. Pjesëmarrja siguron përfaqësimin e serbëve në institucionet e Kosovës por gjithashtu i mvesh me legitimitet këto institucione, duke bërë që disa ta barazojnë pjesëmarrjen me njojhen e pavarësisë së Kosovës. Në anën tjetër, bojkoti është në pajtim me politikën e mosnjohjës por i lë serbët jashtë procesit vendimmarrës. Si rezultat i kësaj dileme, pjesëmarrja nga rreth 70,000<sup>1</sup> serbë në jug dhe bojkoti nga afërsisht 50,000 serbë në veri siguron përfaqësimin e serbëve në jug por i lë menjanë serbët e veriut, duke i zgjeruar edhe më tej ndasitë veri-jug dhe duke e fuqizuar idenë e ndarjes, ide që mbështetet nga serbët që jetojnë të koncentruar në veri, por që kundërshtohet nga komunat e shpërndara serbe në pjesën tjetër të Kosovës.

Serbët në jug përkrahin pozicionin e Beogradit të “mosnjohjes” por jo edhe ate të “mosbashkëpunimit”. Ata besojnë se ekzistojnë modele të cilat lejojnë për “bashkëpunim pa njojje” dhe “pranim por jo njojje” të institacioneve të Kosovës. Kjo qasje nënkupton pjesëmarrjen e serbëve në institucione, përfshire policinë, gjyqësinë dhe administratën publike por jo njojhen e prerogativave sovrane të Kosovës, sic janë kufijtë dhe simbolet shtetërore.

Serbët në veri nuk pritet të ndryshojnë strategjinë e tyre të “mosangazhimit”. Por serbët në jug, të rrethuar nga vendbanime me popullatë shqiptare dhe të varur nga institucionet e Kosovës dhe komuniteti ndërkombëtar për ofrimin e sigurisë dhe shërbimeve tjera, konsiderojnë se pjesëmarrja në institucionet e Kosovës është thelbësore për mbijetesë. Ata fuqishëm kundërshtojnë ndarjen eventuale të veriut, kryesisht për shkak se ata përseni do të mbeteshin përbrenda “kufijve të rinj” të Kosovës.

1 Ky është një numër i përafert. Të dhëna të sakta për serbët, apo edhe për shqiptarët, nuk ekzistonj. Regjistrimi i fundit i popullsisë është mbajtur në vitin 1981. Megjithatë, ekziston pajtimi se shumica e serbëve në Kosovë jeton në jug të lumit Ibër. Ky fakt është përdorur shpesh gjatë diskutimeve si argument kundër ndarjes së Kosovës sepse do të linte shumicën e serbëve në Kosovë jashte Serbisë.

## Rekomandime

- Serbët në jug duhet të marrin pjesë në institucionet e Kosovës.** Serbët në jug duhet të marrin pjesë në institucionet e Kosovës, përfshirë policinë, gjyqësinë dhe administratën publike si dhe të shfrytëzojnë sistemin e kuotas. Problemet dhe sfidat e komunitetit serb—decentralizimi, institucionet lokale, punësimi, telekomunikimi, prona e kështu me rradhë—më së miri do të mund të adresoheshin përmes pjesëmarrjes në institucionë. Bojkotimi i institucioneve të Kosovës nga ana e serbëve në veri nuk duhet ti shkurajoj serbët e jugut nga pjesëmarrja. Serbët në jug dhe serbët në veri jetojnë në rrithana të ndryshme, prandaj nevojitet që veprimet e tyre t'u përshtaten kushteve në terren. Me pjesëmarrje serbët mund t'i japin pak legitimitet pavarësisë së Kosovës por do të përfitonin fuqi substanciale politike.
- Beogradi duhet të përkrah pjesëmarrjen politike të serbëve në jug.** Beogradi duhet ta njoh vendimin e serbëve të jugut për pjesëmarrje në institucionet e Kosovës. Edhe pse Beogradi mund të mos jetë në pozitë që publikisht ta mbështesë pjesëmarrjen, sepse do të dukej sikur ua kthen shpinën institucioneve të Serbisë në Kosovë, ai nuk duhet ta pengojë atë. Përkrahja mund të ofrohet përmes projekteve të përbashkëta me institucionet komunale në komunat me shumicë serbe si dhe përmes bashkepunimit joformal me partitë politike serbe në Kosovë.
- Serbët në veri duhet ta mbështesin pjesëmarrjen e serbëve në jug.** Serbët në veri duhet ta pranojnë faktin se serbët në jug jetojnë në rrithana tjera dhe duhet ta mbështesin pjesëmarrjen e tyre në institucionet e Kosovës. Për dallim nga serbët në veri, Serbët në jug varen për shumë shërbime nga institucionet e Kosovës. Përderisa në veri institucionet e Serbisë funksionojnë, ne jug ato janë pothuajse inekzistente. Poashtu një shkallë solidariteti dhe mirëkuptimi e serbëve në veri për serbët në jug do të përmirësonte marrëdhëniet brenda komunitetit serb në Kosovë.
- Institucionet e Kosovës duhet ta përkrahin pjesëmarrjën e tanishme të pjesëmarrje politike të serbëve.** Një numër i partive politike shqiptare dhe zyrtarëve qeveritarë frikësohen se integrimi i serbëve të jugut në institucionet e Kosovës, përderisa serbët e veriut largohen gjithnjë e më shumë nga Prishtina, do ta përforcoj idenë e ndarjes. Megjithatë, institucionet e Kosovës duhet të mbështesin integrimin e serbëve në jug sepse një gjë e tillë jo vetëm që do ta akomodonte një pjesë të madhe të komunitetit serb por gjithashtu do të shërbente si shembull i mirë i bashkëjetesës dhe bashkëqeverisjes shqiptaro-serbe dhe përmirësoj marrëdhëniet e përgjithshme mes dy shoqërive.

# POLITIKA E BEOGRADIT PËR KOSOVËN

Pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës në vitin 2008, Beogradri pezulloj komunikimin me Prishtinën, organizoi zgjedhje lokale në Kosovë dhe themeloi institucionet e tij. Beogradri poashtu ‘dënoi’ ata serbë që devijuan nga kjo politike. Qe nga atëherë Beogradri ka bërë tri ndryshime madhore politike: ka rivendosur komunikimin me Prishtinën përmes një dialogu mbi cështjet ‘teknike’; nuk i sanksionon më ata që votojnë, kandidohen apo që u bashkohen institucioneve të Kosovës; si dhe ka mbyllur një numër të institucioneve lokale të Serbisë në komunat e Kosovës më numër të vogël apo pa popullatë serbe. Përkundër këtyre modifikimeve të politikave, Beogradri kundërshton pjesëmarrjen dhe angazhimin e serbëve në institucionet e Kosovës. Serbët në jug kanë ‘devijuar’ nga kjo politikë, duke dalur të votojnë në numër të madh në zgjedhjet lokale të Kosovës të vitit 2009 dhe në ato parlamentare të vitit 2010.

## Rekomandime

- Beogradri dhe deputetët serbë të parlamentit të Kosovës duhet të vendosin kanale të komunikimit dhe bashkëpunimit.** Beogradri duhet të vendosë komunikim dhe bashkëpunim joformal me 13 deputetët serbë në parlamentin e Kosovës dhe gradulish ta formalizoj këtë bashkëpunim. Beogradri nuk e njeh parlamentin e Kosovës. Por ai nuk e njeh as qeverinë e Kosovës, me të cilën është futur në dialog direkt nën një strategji “angazhim pa njohje”. E njëjtë strategji mund të zbatohet për bashkëpunim me deputetë dhe parti parlamentare serbe në Kosovë. Bashkepunimi mund të filloj me takime joformale mes serbëve të Kosovës që janë deputetë në parlamentin e Serbisë dhe serbëve të Kosovës që janë deputetë në parlamentin e Kosovës
- Beogradri duhet të involvojë më shumë serbët në Kosovë në bërjen e politikave të tij për Kosovën.** Politika e Beogradit për Kosovën duhet të definohet qartë, të jetë pragmatike dhe fleksibile si dhe të marrë parasysh rekomandimet dhe vlerësimet e serbëve në Kosovë. Ata duhet të jenë pjesë e politikës dhe faktor kryqë procesin e implemetimit të politikave. Kjo do të mund të arrihet përmes krijimit të një trupi këshilldhënës të përbërë nga zyrtarë qeveritar të Serbisë, përfaqësues politik dhe anëtarë serbë të shoqërisë civile.
- Beogradri duhet të rrisë transparancën dhe efikasitetin e fondeve të dedikuara për Kosovën.** Beogradri duhet të jetë më transparent, efikas dhe llogaridhënës në menaxhimin e fondeve të Serbisë të dedikuara për serbët në Kosovë. Më shumë fonde duhet të ndahen për edukim dhe zhvillim ekonomik, e më pak për ndihmë sociale.

4. **Beograd duhet të përmirësojë marrëdhëniet me Prishtinën.** Beograd duhet të luajë rol konstruktiv në angazhimin e tij me Prishtinën. Marrëdhëniet e mira mes Beogradit e Prishtinës do të reflektohen në marrëdhëniet mes shqiptarëve dhe serbëve në Kosovë.

## DIALOGU BEOGRAD-PRISHTINË DHE SERBËT NË KOSOVË

Gjendja e komunitetit serb në Kosovë do të jetë një pikë kyce e dialogut Beograd-Prishtinë. Nëse është i suksesshëm, dialogu do të definoj rolin e serbëve në procesin politik në Kosovë, do të zgjidh disa cështje jopolitike, do të gjejë zgjedhje për veriun dhe përfundimisht do t'i jepet fund pasigurisë politike të komunitetit serb.

Dialogu Beograd-Prishtinë pritet të jetë i gjatë dhe i vështirë. Edhe pse zyrtarisht ai adreson cështje teknike, sesionet e para sugjerojnë se ndarja e cështjeve teknike nga ato politike është e vështirë. Dokumentet e udhëtimit, targat e automjeteve, dhe vulat doganore janë cështje teknike por edhe politke. Mungesa e një agjende zyrtare për dialog e bën të vështirë definimin e një modeli për angazhim të komunitetit serb në këtë proces.

### Rekomandime

1. **Përfaqësuesit serbë në Kosovë duhet të formulojnë një listë të prioriteteve për dialogun.** Serbët në Kosovë duhet të formulojnë një listë të prioriteteve dhe të angazhohen për ta bërë atë pjesë të agjendës. Edhe pse dialogu pashmangshëm do ta adresojë gjendjen e serbëve në Kosovë, interesat tjera të konsideruara më të rëndësishme nga Beogradit dhe Prishtina mund t'i lënë nën hixe interesat e serbëve. Standardi i jetesës–energjia e vazhdueshme elektrike dhe linjat telefonike, siguria, punësimi e kështu me rradhë–duhet të ketë përparësi ndaj interesave më të mëdha e abstrakte të Beogradit e Prishtinës. Udhëheqësit e komunitetit serb duhet të janë pjesë e sesioneve punuese të dialogut që meren me cështje si ato të trashëgimisë kulturore, dokumentet e udhëtimit, targat e automjeteve, të pagjeturit, transporti, bashkëpunimi policor, gjyqësia, tregtia dhe telekomunikimi.
2. **Serbët në Kosovë duhet të përgatisin një platformë të përbashkët për dialog.** Serbët në Kosovë presin që të inkuadrohen në grupet punuese të Beogradit e Prishtinës. Anëtarët e partive parlamentare serbe në Kosovë pritet të inkuadrohen në ekipe e Prishtinës, kurse anëtarët nga Kosova të partive më seli në Beograd pritet të janë pjesë e ekipit të Beogradit. Anëtarët e të dyja ekipeve duhet të punojnë pikësëpari në cështjet që prekin komunitetin serb.

3. **Beograd i duhet tē artikulojë qëllime realiste pér dialog.** Beograd i duhet tē jetë realist në artikulimin e qëllimeve pér dialogun me Prishtinën dhe nuk duhet ti përsërisë gabimet e negociatave tē kaluara. Partneriteti me komunitetin ndërkombëtar, i cili është lehtësues i procesit, është thelbësor pér Beogradin.

## MUNDËSITË EKONOMIKE

Qëndrueshmëria ekonomike e komunitetit serb duhet tē konsiderohet brenda një konteksti më tē gjërë ekonomik në Kosovë. Nëse shikohet e izoluar, analiza do tē jetë gjysmake. Ekonomia e kosovës është e bazuar në burime të paqëndrueshme: shpenzime qeveritare, remitanca dhe ndihma ndërkombëtare. Si shqiptarët ashtu edhe serbët varen nga ndihmat sociale, qofshin ato remitanca nga diapora shqiptare pér shqiptarët apo pagesa sociale nga qeveria e Serbisë pér serbët. Mirépo, edhe këto burime po zbehen: tē ballafaquar me deficite buxhetore, qeveritë në Beograd e Prishtinë po zgjedholnë shpenzimet; remitançat po zgjedholen; Beograd i redukton pagesat sociale pér serbët në Kosovë; dhe ndihma financiare ndërkombëtare po bie.

Prodhimi i përgjithshëm vendor (GDP) i Kosovës është rreth 4 miliard euro<sup>2</sup>, afersisht 2,000 euro pér kokë banori. Madje edhe me standarde të Ballkanit ky është një nivel shumë i ulët. GDP-ja pér kokë banori e Bosnjës dhe Hercegovinës është rreth 5,000 euro, e Shqipërisë rreth 6,000, e Maqedonisë 7,000, dhe e Serbisë rreth 8,000. Kosova ka një deficit tregtar marramendës. Vlera e eksportit pér vitin 2010 ka qenë afro 300 milion euro, kurse ajo e importit rreth 2.3 miliard euro. Niveli i papunësisë është afër 45 përqind. Rreth 35 përqind e popullatës jeton në varfëri. Në këto kushte, është e vështirë tē krijohen mundësi ekonomike pér cilindë komunitet në Kosovë. Megjithatë, komuniteti serb është më së paku aktiv në jetën ekonomike.

## Rekomandime

1. **Komuniteti serb duhet tē aktivizojë potencialin e tij ekonomik.** Përpjekjet pér tē rimëkëmbur potencialin e komunitetit serb duhet tē fokusohen në shfrytëzimin e resurseve njerëzore të papërdorura dhe në eliminimin e sindromit të "ikjes së trurit". Të ballafaquar me papunësi, shumica e serbëve të arsimuar shkojnë në Serbi në kërkim të punësimit. Nëqoftëse ky trend nuk ndalohet, pasojat pér komunitetin serb do tē jenë tē rënda.
2. **Beograd i duhet tē japë kredi me interes tē ulët dhe subvencione pér serbët në Kosovë.** Qeveria e Serbisë duhet tē ndajë një pjesë tē buxhetit të dedikuar pér serbët në Kosovë pér tu dhënë kredi me interes tē ulët ndërmarrjeve tē vogla dhe tē mesme. Subvencione pér fermerët lokal duhet

2 The CIA World Factbook 2010.

të alokohen poashtu. Kjo do të fuqizonte bazën ekonomike të serbëve si dhe do të zvogëlonë varësinë e tyre në pagesa sociale.

3. **Beogradit duhet të vazhdojë asistencën e tanishme sociale për serbët në Kosovë.** Derisa të krijohet një bazë ekonomike, pagesat sociale të qeverisë së Serbisë për serbët në Kosovë duhet të vazhdojnë. Këto ndihma janë esenciale për mbijetesën e tyre. Në ndërkokë, serbët së bashku me qeverinë e Serbisë dhe institucionet e Kosovës duhet të përkrahin iniciativa të cilat promovojnë aktivitet ekonomik.
4. **Serbët në Kosovë duhet të shfrytëzojnë sistemin e kuotas.** Serbët në Kosovë duhet të shfrytëzojnë sistemin e kuotas për punësim në administratë publike, polici, gjyqësi e kështu me rradhë. Duke marr parasysh se sektori privat është shumë i dobët dhe do të mbetet i tillë për një kohë, punësimi në institucionë dhe kompani publike mbetet opsjon i vetëm.

# PARTICIPANTS\* | UČESNICI\* | PJESEMARRËSIT\*

## Miloš Andić

Serbian Renewal Movement  
Srpski pokret obnove  
Lëvizja e Ripërtirjës Serbe

## Ćedomir Antić

Progressive Club  
Napredni klub  
Klubi Progresiv

## Jelena Bontić

Independent Liberal Party  
Samostalna liberalna stranka  
Partia e Pavarur Liberale

## Nenad Cvetković

Independent Democratic Party  
Samostalna demokratska stranka  
Partia e Pavarur Demokratike

## Saša Đokić

Serb Democratic Party of Kosovo and Metohija  
Srpska demokratska stranka Kosova i Metohije  
Partia Demokratike Serbe e Kosovës dhe Metohisë

## Oliver Ivanović

Serbian Ministry for Kosovo and Metohija  
Ministarstvo za Kosovu i Metohiju  
Republike Srbije  
Ministria e Serbisë për Kosovë e Metohi

## Dušan Janjić

Forum for Ethnic Relations  
Forum za etničke odnose  
Forumi për Marrëdhëniet Etnike

## Dalibor Jevtić

Independent Liberal Party  
Samostalna liberalna stranka  
Partia e Pavarur Liberale

## Vesna Jovanović

Social Democratic Party  
Socijaldemokratska partija  
Partia Social Demokratike

## Biserka Kostić

Independent Liberal Party  
Samostalna liberalna stranka  
Partia e Pavarur Liberale

## Dragiša Krstović

Liberal Democratic Party  
Liberalno-demokratska partija  
Partia Liberal Demokratike

## Goran Marinković

Independent Liberal Party  
Samostalna liberalna stranka  
Partia e Pavarur Liberale

## Milivoje Mihajlović

Serbian Prime Minister's Office for Media Relations  
Kancelarija Predsednika Vlade Srbije za odnose s medijima  
Zyra për Marrëdhënie me Media e Kryeministratit të Serbisë

## Vesna Mikić

United Serb List  
Jedinstvena srpska lista  
Lista e Bashkuar Serbe

## Petar Milić

Independent Liberal Party  
Samostalna liberalna stranka  
Partia e Pavarur Liberale

## Saša Milosavljević

Independent Liberal Party  
Samostalna liberalna stranka  
Partia e Pavarur Liberale

## Bratislav Nikolić

Independent Liberal Party  
Samostalna liberalna stranka  
Partia e Pavarur Liberale

## Dragan Nikolić

Radio Kompas

## Randel Nojkic

Serbian Renewal Movement  
Srpski pokret obnove  
Lëvizja e Ripërtirjës Serbe

\* The list includes participants that took part in one or more events of the initiative.

Lista obuhvata one koji su učestvovali na jednom ili više događaja ove inicijative.

Lista përfshin pjesëmarrës të një apo më shumë organizimeve të iniciativës.

<b>Veljko Odalović</b> Socialist Party of Serbia Socijalistička partija Srbije Partia Socialiste e Serbisë	<b>Mihailo Šćepanović</b> Serb People's Party Srpska narodna stranka Partia e Popullit Serb
<b>Zoran Ostojić</b> Liberal Democratic Party Liberalno-demokratska partija Partia Liberal Demokratike	<b>Vlajko Senić</b> G17 Plus Party G17 Plus Partia G17 Plus
<b>Nebojša Perić</b> Citizens Group Vidovdan Grupa građana Vidovdan Grupi Qytetarë Vidovdan	<b>Srđan Sentić</b> Kosovo Office of Community Affairs Kancelarija Kosova za pitanja zajednica Zyra e Kosovës për Çështje të Komuniteteve
<b>Vesna Pešić</b> Liberal Democratic Party Liberalno-demokratska partija Partia Liberal Demokratike	<b>Predrag Simić</b> University of Belgrade Univerzitet u Beogradu Universiteti i Beogradit
<b>Stojanka Petković</b> G17 Plus Party G17 Plus Partia G17 Plus	<b>Bojan Stojanović</b> Independent Liberal Party Samostalna liberalna stranka Partia e Pavarur Liberale
<b>Slobodan Petrović</b> Independent Liberal Party Samostalna liberalna stranka Partia e Pavarur Liberale	<b>Boban Todorović</b> Independent Liberal Party Samostalna liberalna stranka Partia e Pavarur Liberale
<b>Srđan Popović</b> Independent Liberal Party Samostalna liberalna stranka Partia e Pavarur Liberale	<b>Radojica Tomić</b> Independent Liberal Party Samostalna liberalna stranka Partia e Pavarur Liberale
<b>Dejan Radenković</b> Socialist Party of Serbia Socijalistička partija Srbije Partia Socialiste e Serbisë	<b>Momčilo Trajković</b> Serbian Resistance Movement Srpski pokret otpora Lëvizja e Rezistencës Serbe
<b>Nenad Radosavljević</b> RTV Mir	<b>Rada Trajković</b> United Serb List Jedinstvena srpska lista Lista e Bashkuar Serbe
<b>Živojin Rakočević</b> Radio KiM	<b>Ivan Vejvoda</b> Balkan Trust for Democracy Balkanski fond za demokratiju Trusti i Ballkanit për Demokraci
<b>Dragoljub Repanović</b> Serbian Radical Party Srpska radikalna stranka Partia Radikale e Serbisë	<b>Danijela Vujičić</b> G17 Plus Party G17 Plus Partia G17 Plus
<b>Branko Ružić</b> Socialist Party of Serbia Socijalistička partija Srbije Partia Socialiste e Serbisë	
<b>Vesimir Savić</b> United Serb List Jedinstvena srpska lista Lista e Bashkuar Serbe	



Council  
for Inclusive  
Governance

## Council for Inclusive Governance

---

### BOARD

**Steven L. Burg** (Chairman), Brandeis University

**Gordon N. Bardos**, Columbia University

**Michael W. Elf**, Macmillan Publishers

**Alex N. Grigorev**, Council for Inclusive Governance

### STAFF

**Alex N. Grigorev**, President

**Shpetim Gashi**, Director of Programs

**Robert K. Aitkens**, Accountant

**Arber Kuci**, Program Coordinator

**Ivana Stanojev**, Program Coordinator

**Marija Govedarica**, Program Associate

The Council for Inclusive Governance (CIG) is an international nonprofit, nonpartisan, and non-governmental institution that promotes inclusive and responsive governance. It facilitates constructive dialogue as a means of fostering interparty cooperation, interethnic accord, and interstate collaboration, and carries out analyses of contemporary policy issues. The goal of CIG activities is to build confidence in democratic institutions of governance and contribute to the cohesiveness of political systems and societies.

## CIG Activities Include:

- Conducting innovative and transparent policy dialogues for major stakeholders;
- Facilitating interstate cooperation through international dialogues and exchange of experience;
- Promoting cooperation and consensus on national issues through dialogues between government and opposition;
- Supporting multiethnic states and strengthening common democratic institutions by facilitating consensus-building on issues that divide ethnic communities;
- Fostering trust and inclusive approaches in decision making;
- Providing informed advice and policy analysis;
- Publishing analytical reports and policy papers to advance public understanding of inclusive governance.

**Council for Inclusive Governance**  
[cig@cigonline.net](mailto:cig@cigonline.net)

Online at  
[cigonline.net](http://cigonline.net)

## **A Note on Translation**

The recommendations contained in this report call for accommodation of the needs of Serbs in Kosovo. They call for appropriate adjustment of policies and actions on the part of governments in response to the difficult problems of the Serbs. In the draft report circulated to participants for review, CIG translated the English term “accommodation” into Serbian as “prilagođavanje”. There were no objections to this translation. After completion of the printing, suggestions were made that “položaj” might be a more accurate Serbian translation of the English version. CIG consulted with participants, professional translators, and several area specialists, who confirmed the translation accurately reflects the nuances of these recommendations. Consistent with our respect for the opinions of all participants, and our commitment to transparency, CIG decided to inform our readers of this question and our decision through this additional note. We welcome the close attention and interest of our participants in making sure CIG “gets it right”.

*Council for Inclusive Governance*

New York, May 2011

## **Napomena u vezi sa prevodom**

Preporuke koje su sadržane u ovom izveštaju ukazuju na potrebu za zadovoljavanjem potreba Srba na Kosovu. U preporukama se traži i prilagođavanje mera politike i delovanja vlada u rešavanju teških problema sa kojima se suočavaju Srbi. U nacrtu izveštaja koji je podeljen učesnicima, CIG je izraz “accommodation” preveo kao “prilagođavanje”, na što nije bilo primedbi. Po štampanju izveštaja, sugerisano nam je da bi izraz “položaj” bio precizniji u prevodu na srpski engleske verzije. CIG se konsultovao sa učesnicima, profesionalnim prevodiocima i nekolicinom stručnjaka koji su potvrdili da prevod precizno oslikava nijanse ovih preporuka. Dosledno našem poštovanju mišljenja svih učesnika, kao i našoj posvećenosti transparentnosti, CIG je odlučio da obavesti svoje čitaoce o ovom pitanju i o našoj odluci u ovoj napomeni. Pozdravljamo dužnu pažnju i interesovanje naših učesnika u želji da CIG uradi “sve kako treba”.

*Savet za inkluzivno upravljanje*

*Njujork, maj 2011*

## **Sqarim rreth perkthimit**

Rekomandimet tē cilat janē pjesë e këtij rapporti bëjnë thirrje pēr akomodimin e nevojave të serbëve në Kosovë. Këto rekomandime sygjerojnë përshtatjen e drejtë tē politikave dhe veprimeve nga ana e qeverisë përballë problemeve të vështira të serbëve. Në draftin e parë tē rapportit, i cili i është dhënë pjesëmarrësve pēr shqyrtim, termi i gjuhës angleze “accommodation”, në gjuhën serbe nga CIG është përkthyer si “prilagođavanje”. Me këtë rast, nuk ka pasur kundërshtime. Megjithate, pas shtypjes sē rapportit final, fjala “položaj” është konsideruar si përkthim më i përafërt i termit tē njejtë nga gjitha angleze. CIG është konsultuar me pjesëmarrësit, përkthyesit profesionistë, dhe me njohës tjerë tē kësaj fushe dhe tē gjithë janë pajtuar se ky përkthim nē mënyrë tē drejtë pasqyron nuansat e këtyre rekomandimeve. Duke pasur rrespekt pēr opinionet e tē gjithë pjesëmarrësve, si dhe e bazuar nē përkushtimin pēr transparencë, CIG ka vendosur që përmes këtij njoftimi t'i informojë lexuesit e këtij rapporti rreth ndryshimit që është bërë. Ne mirëpresim kujdesin e veçantë dhe interesimin e shtuar tē pjesëmarrësve tanë pēr t'i ndihmuar CIG, që t'i kuptojë dhe ti adresojë problemet nē mënyrën më tē mirë.

*Këshilli pēr Qeverisje Inkluzive*

*Nju Jork, maj 2011*